

**INSTITUCIONET
MUZEALE
TË QYTETIT TË
GJAKOVËS**

Dhjetor, 2024



Institucionet Muzeale të qytetit të Gjakovës

Analizë dhe dokumentim i gjendjes ekzistuese të institucioneve muzeale të qytetit të Gjakovës.

Autorë: Arta Januzi Cana
Blerta Breznica
Flaka Xërxa Beqiri
Marigona Rexha

Botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Hulumtimi "Institucionet Muzeale të qytetit të Gjakovës" është realizuar nga EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Trashëgimia kulturore për të gjithë: Ruajtja, edukimi, zhvillimi dhe inovacioni" përkrahur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të donatorit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË
DHE SPORTIT

PËRMBAJTJA



HYRJE



1 METODOLOGJIA E APLIKUAR DHE OBJEKTIVAT E HULUMTIMIT



2 ZHVILLIMI HISTORIK I INSTITUCIONEVE MUZEALE: KATEGORIZIMI DHE VEÇORITË FUNKSIONALE



3 INSTITUCIONET MUZEALE NË KOSOVË



4 MUZETË E QYTETIT TË GJAKOVËS

4.1. GJENDJA EKZISTUESE FIZIKE

4.2. ANALIZA E HAPËSIRAVE DHE SEKUENCAT E LËVIZJEVE

4.3. QASSHMËRIA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME



BIBLIOGRAFIA

LISTA E FIGURAVE



PËR EC



SHTOJCA 1: DOKUMENTIMI DHE ANALIZA E INSTITUCIONEVE MUZEALE TË QYTETIT TË GJAKOVËS – PJESA GRAFIKE

AKRONIMET

MKRS – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

IAK – Instituti Arkeologjik i Kosovës

DKRS – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

PAK – Persona me Aftësi të Kufizuara

Hyrje

Muzeu është një institucion jofitimprurës, në mënyrë konstante në shërbim të shoqërisë, që hulumton, mbledh, konservon, interpreton dhe ekspozon trashëgiminë e prekshme dhe të paprekshme. Duke qenë të hapura dhe gjithëpërfshirëse për publikun, muzetë nxisin diversitetin e qëndrueshmërinë, duke ofruar përvoja të ndryshme për edukim, rekreim, reflektim dhe shkëmbim njohurish¹. Ndër objektivat më të rëndësishme të muzeut konsiderohen mbrotja e trashëgimisë kulturore, edukimi i përgjithshëm, insipirimi kreativ e të menduarit kritik, rrjedhimisht duke ofruar hapësirë për kërkim dhe zhvillim diskursesh. Përmes aktiviteteve të gjëra si, koleksione të kuruara, ekspozita të përkohshme, programe të ndryshme edukuese, vizita të organizuara e të tjera, synohet

përfshirja e vizitorëve dhe promovimi i njohjes së objekteve fizike dhe ideve të ekspozuara. Si i tillë, muzeu përbën një kategori ndërtesash arkitektonike të cilat nuk përbëjnë interes për shoqërinë vetëm si struktura fizike dhe kualitete estetike që ato përfaqësojnë, por edhe për institucionalizmin të cilin e bartin si epitete. Më konkretisht, muzetë cilësohen si institucione që kujdesen për koleksionim të artefakteve kulturore, historike dhe shkencore, të cilat i vënë në dispozicion të publikut dhe të cilat, varësisht nga kategorizimi i vet ekspozitës të cilës i takojnë, mund të jenë pjesë të ekspozitave të përhershme apo të përkohshme².

Të dhënat statistikore të publikuara lidhur me numrin e institucioneve muzeale në Kosovë konsiderohen të limituara, si për ato të nivelit qendror ashtu edhe lokal³.

¹ Definicioni i ri i muzeve, propozuar nga Këshilli Nërkombëtar i Muzeve (ICM – International Council of Museums), aprovuar në Konferencën e 26-të Gjenerale mbajtur në Pragë, më 24 Gusht 2022, qasur në Nëntor 2022, <https://icom.museum/en/news/icom-approves-a-new-museum-definition/>

² Alexander, E.P., Alexander, M., “Museums in motion: an introduction to the history and functions of museums”, Rowman & Littlefield, 2007

³ EC Ma Ndryshe, “Prizreni ‘qytet muze’ pa muze?”, Maj 2008, qasur në Nëntor 2022 <https://www.ecmandryshe.org/?page=1,17,530>

Shumica e tyre i takojnë kryesisht kategorisë së muzeve të historisë, arkeologjisë, etnologjisë dhe diciplina të tjera të ngjashme.

Në mungesë të një strukture legjislative për muzetë, *Koncept Dokumenti për Art dhe Kulturë* i miratuar nga Qeveria e Kosovës, ndër të tjera përcakton, në cilësinë e objektivës strategjike nr.2, reformimin organizativ, funksional dhe konsolidimin e brendshëm të institucioneve publike të kulturës dhe të muzeve. Ndër objektivat kryesorë të këtij dokumenti janë:

(2.1) Krijimi i strukturave me përgjegjësi të përcaktuar qartë në promovimin kulturor, zhvillimin e hulumtimeve dhe publikimin e studimeve si dhe ruajtjen e trashëgimisë dhe krijimtarisë kulturore; (2.2) Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare dhe funksionale të institucioneve publike përmes centralizimit të përgjegjësi për

menaxhim financiar dhe administrativ të brendshëm;

(2.3.) Digjitalizimi dhe qasja në materiale dhe koleksione kulturore;

(2.4) Ngritja e kapaciteteve njerëzore në fushën kulturës dhe krijimit të strukturave funksionale profesionale, teknike, administrative dhe logjistike⁴. *Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027* është një tjetër dokument i cili parasheh definimin e statutit të institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe themelimin e institucioneve të reja, siç është Muzeu Arkeologjik, Muzeu Etnologjik dhe Muzeu i Historisë së Natyrës, krahas masave tjera të përfshira të cilat adresojnë përmirësimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të trashëgimisë kulturore dhe realizimin e programeve trajnuese për ciceronë dhe kuratorë muzeal, menaxherë, laborantë dhe profesionistë të tjerë të lidhur me fushën e muzeologjisë.⁵

⁴ MKRS – faqja zyrtare, “Miratohet Koncept- dokumenti për Art dhe Kulturë” qasur në Nëntor, 2022, <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,3041> .Y6bo1i-B2X0

⁵ Jerliu, F., “Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017 – 2027”, Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, 2016

Muzetë sot ndërkombëtarisht ballafaqohen me tendencën e evoluimit nga hapësirat e dedikuara kryesisht për ekspozim të eksponateve të artit, shkencës e historisë, në ato me edukim e ngritje joformale duke përfshirë biblioteka, galeri arti, hapësira për zhvillimin e projekteve të cilat trajtojnë dhe pesë dimensione duke pasuruar kështu jetën shoqërore⁶. Duke qenë se në Kosovë mungesa e dokumentuar rreth gjendjes ekzistuese si dhe planifikimeve afatshkurtëra dhe afatgjata të institucioneve muzeale është evidente, ky hulumtim synon të analizoj dhe dokumentoj gjendjen ekzistuese të muzeve të qytetit të Gjakovës, të cilit hulumtim i paraprijnë dy të realizuar nga EC mbi institucionet muzeale të dy qyteteve të tjera të Kosovës; institucioneve muzeale të Prizrenit gjatë vitit 2022, dhe institucioneve muzeale të Mitrovicës gjatë vitit 2023/24. Hulumtimi i parë ka trajtuar pesë muzetë kryesore të qytetit të Prizrenit, duke përfshirë:

(1) Muzeun Arkeologjik – Hamami i Shemsidin Beut dhe Sahatkulla, (2) Muzeun Etnologjik – Shtëpia e Shehzades, (3) Muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, (4) Muzeun e Kalasë së Prizrenit dhe (5) Muzeun e Elektroekonomisë – Hidroelektrana “Prizrenasja”, ku gjetjet kanë evidentuar të kenë nevoja substanciale lidhur me shërbimet e ofruara, organizimin dhe mënyrën e ekspozimeve të artefakteve.

Hulumtimi i dytë në Mitrovicë ka trajtuar tre muze: Muzeu i Qytetit, Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve-TREPÇA dhe Kompleksi i Kullave Isë Boletini (i cili zyrtarisht ende nuk është i regjistruar si muze, mirëpo operon si i tillë). Ky hulumtim, i treti me radhë, trajton institucionet muzeale të qytetit të Gjakovës, duke përfshirë: Muzeun Etnografik të Gjakovës, Shtëpinë e Familjes Qerkezi, Muzeun e Muzikës si dhe Muzeun Historik – Kulla e Abdullah Pashë Drenit.

⁶ Günay, B., “Museum concept from past to present and importance of museums as centers of art

SHËNIM: Në këtë hulumtim është përfshirë studimi më i hollësishëm i Muzeut Etnografik të Gjakovës dhe i Shtëpisë së Familjes Qerkezi, ndërsa në Muzeun e Muzikës si dhe Muzeun Historik – Kulla e Abdullah Pashë Drenit ka qenë qasja e pamundur për shkak të gjendjes së tyre nën restaurim.

*Fig. 1 Ilustrim i katër institucioneve muzeale të qytetit të Gjakovës të përfshira në këtë hulumtim.
(Burimi: Punuar nga autoret)*

1981

MUZEU
ETNOGRAFIK I
GJAKOVËS

2016

SHTËPIJA E
FAMILJES
QERKEZI

2016

MUZEU I
MUZIKËS

2010

MUZEU HISTORIK -
KULLA ABDULLAH
PASHË DRENIT



1. METODOLOGJIA E APLIKUAR DHE OBJEKIVAT E HULUMTIMIT

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është identifikimi i problemeve aktuale dhe potencialeve që Institucionet muzeale të qytetit të Gjakovës bartin sa i përket vlerave të trashëgimisë kulturore dhe shoqërore, rrjedhimisht dokumentimin e infrastrukturës së tyre fizike.

Përmes analizave operacionale, ky hulumtim vlerëson tërheqjen e vizitorëve si dhe potencialin e tyre për t'iu përgjigjur reformimeve të kohës drejt tendencave të institucioneve muzeale atraktive. Qasshmëria e personave me aftësi të kufizuara në këto institucione është gjithashtu pjesë vitale e analizave operacionale. Hulumtimi është i bazuar fillimisht në literaturë ekzistuese, të dhënave zyrtare nga organet kompetente, intervistave me zyrtar si dhe vrojtimit në teren të gjendjes ekzistuese.



2. ZHVILLIMI HISTORIK I INSTITUCIONEVE MUZEALE: KATEGORIZIMI DHE VEÇORITË FUNKSIONALE

Dy hulumtimet paraprake të EC Ma Ndryshe kanë të dhëna të shumta sa i përket zhvillimit historik dhe veçorive të tjera të insitucioneve muzeale në përgjithësi. Në këtë kaptinë janë rikapitulluar disa nga informatat më të rëndësishme.

Në fillet e historisë së muzeve, fjala “muze” vlente për një *koleksion*, e jo për një ndërtesë siç do të mendohej. Vetëm nga fundi i shekullit të tetëmbëdhjetë, kur u krijua ideja e muzeut dhe u ndërtua ndërtesa e parë e pavarur, me funksion të destinuar si muze, u krijua dhe një tipologji e re arkitekturore, ajo e ndërtesave muzeale, e cila mbeti deri në fillim të shekullit të njëzetë⁷.

Muzetë, si ndërtesa arkitekturore janë zhvilluar me hapa të mëdhenj përgjatë shekujve të kaluar, nëpër tipologji të ndryshme. Historikisht, bazuar në kumtesën e lexuar në takimin e Asociacionit të Muzeve në Newcastle (23 Korrik 1895)⁸,

institucionet muzeale mund të ndahen sipas llojit të koleksionit (Muzeu i Arteve, Muzeu i Historisë, i Antropologjisë, i Historisë së Natyrës, i Teknologjisë dhe Muzeu i Zhvillimit Ekonomik) dhe qëllimit në bazë të të cilit janë themeluar (Muzeu Kombëtar, Muzetë Lokal, të Qytetit apo Provincës, Muzeu i Shkollës apo Universitetit, Muzeu Profesional, ato tëspecializuara të një lëmie të caktuar të studimit, të zotuar nga individ apo shoqata). Për më shumë, ndër tipologjitë tjera mund të listohen edhe: muzetë arkitekturore, muzetë arkeologjike, muzetë e artit, muzetë e automobilave, muzetë e dizajnit, muzetë e fëmijëve, muzetë etnologjike / etnografike, muzetë ushtarake dhe të luftës, muzetë e shkencës, muzetë virtuale etj.

⁷Tzortzi, K. “Museum Space- Where Architecture Meets Museology”, Routledge, 2016, fq. 11-43

⁸Goode, G.B., “On the Classification of Museums

PËRMBAJTJET FUNKSIONALE TË HAPËSIRAVE

Në përgjithësi, hapësirat funksionale të të gjitha llojeve të muzeve karakterizohen me hollin hyrës, hapësirën pritëse dhe informuese, hapësirat ekspozuese të karakterit tëpërkohshëm dhe të përhershëm, deponinë e ruajtjes së koleksioneve, hapësirën e konzervimit dhe restaurimit si dhe njësitë administrative. Me qëllim të ruajtjes së sigurisë së ekspozateve, është e rëndësishme një ndarje vitale e hapësirave në grupacione si vijon⁹:

- Hyrja, informatat, dyqan i suvenireve, kafene, toaleta dhe garderoba
- Ekspozita e përhershme dhe e përkohshme
- Hapësirat për edukim, salla e ligjeratave dhe hapësirat për studim/hulumtim
- Zyret:administrative, kuratoriale,të konservizimit, të dizajnit etj.

- Punëtoritë për konzervim, labororet, paisjet e përpunimit të materialeve digjitale
- Depo e ruajtjes së koleksionit, hapësirat e sigurimit dhe inspektimit
- Mirëmbajtja e koleksionit të ekspozitës dhe punëtorive

Përcaktimi i tipologjisë së rrugëtimit të vizitorëve me qëllim frekuentimin e hapësirave ekspozuese dhe të gjitha hapësirave tjera përbërëse të cilat krijojnë një interaksion në tërësi është irëndësishëm që në fillim të procesit të projektimit funksional të muzeve. Lidhur me këtë ekzistojnë disa tipologjitë sekuencave të cilat vizitorët mund të ndjekin në një objekt muzeal: (a) i hapur, (b) qendror dhe me kthina anësore, (c) linear, (d) rrethor, (e) kompleks dhe (f) në formë labirinthi¹⁰.

⁹ Ed. Littlefield, D., "Metric Handbook – Planning and Design Data, Third Edition, Elsevier Ltd., 2008, fq.450 - 455

¹⁰ Ibid.

UDHËHEQJA DHE ADMINISTRIMI

Në botë aplikohen modele të ndryshme administrimit të muzeve dhe kjo përfaktin se një model i caktuar derivon nga diversiteti i koleksioneve të muzeve, por gjithashtu pasqyron një ambivalencë në të kuptuarit e rolit të muzeve në shoqëri, varësisht nëse muzetë janë ekspozues dhe interpretues të trashëgimisë kulturore, depozitorë të ekspozateve me vlerë lidhur me historinë njerëzore dhe natyrore, instrumente për interaksion social në zhvillimin e një shoqërie apo vetëm hapësira për rekreim dhe kalim të kohës së lirë¹¹.

Shumica e muzeve lokale në Kosovë menaxhohen nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, si instrumente të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Muzeu Kombëtar i Kosovës në anën tjetër funksionon si institucion i veçantë kulturor. Megjithatë, nuk përjashtohen edhe rastet e muzeve të cilat janë nën menaxhimin e institucioneve

vartëse të MKRS-së, përkatësisht Institutit Arkeologjik të Kosovës si dhe të organeve të nivelit lokal, siç janë drejtoritë komunale të kulturës dhe turizmit.

QASSHMËRIA DHE DIVERSITETI

Një muze i qasshëm nënkupton të qenit i hapur për të gjitha kategoritë e vizitorëve, duke e bërë kështu përmbajtjen e zhvilluar të komunikueshme, rrjedhimisht arritja e qasshmërisë së plotë tashmë është një mision i përcaktuar dhe zhvilluar tashmë ndërkombëtarisht. Megjithatë, shumë hulumtime dëshmojnë se personat me aftësi të kufizuara ende në të shumtën e rasteve rezultojnë të jenë të privuar në qasshmërinë e tyre në institucionet kulturore, siç janë muzetë.¹²

¹¹ Brittanica, "Museums Structure and Operation", qasur në Nëntor, 2022

¹² Montsho, G., "Making Museums Accessible to Those With Disabilities", Museum Next, 2022, qasur në Nëntor, 2022

3. INSTITUCIONET MUZEALE NË KOSOVË


Është evidente se ekziston një numër i konsiderueshëm i institucioneve muzeale në Republikën e Kosovës, megjithatë ka mungesë të statistikave apo një databaze shtetërore lidhur me numrin e tyre, llojin e ekspozitave, vendndodhjen gjeografike dhe numrin e vizitorëve. Muzeu Kombëtar i Kosovës si një ndër ndërtesat më të vjetra kulturore dhe historike në Kosovë (1949) konsiderohet të jetë në rradhën e muzeve më dominant në kuadër të institucioneve muzeale të Kosovës¹³.

Krahas Muzeut Kombëtar, i cili për qëllim ka ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, në të gjitha qendrat më të mëdha të Kosovës operojnë muzetë e qyteteve. Këta të fundit variojnë për nga kategorizimi, duke funksionuar kryesisht si muze të përgjithshëm rajonal, muze të historisë, muze etnologjik dhe muze arkeologjik.

Fig. 2 Muzeu Kombëtar i Kosovës, Prishtinë.
<https://manifesta14.org/sq/venue/muzeu-i-kosoves/>



¹³ Manifesta14, "Muzeu i Kosovës", qasur në Nëntor 2022,



4. MUZETË E QYTETIT TË GJAKOVËS

Qyteti i Gjakovës numëron gjithsej katër muze, të përfshirë në këtë hulumtim:

- (1) Muzeu Etnografik i Gjakovës**
- (2) Shtëpia e Familjes Qerkezi**
- (3) Muzeu i muzikës**
- (4) Muzeu Historik – Kulla e Abdullah Pashë Drenit**

Institucionet muzeale të Gjakovës trajtojnë, ruajnë dhe prezantojnë koleksione nga qyteti dhe rajoni i Gjakovës. Për nga fushëveprimi Muzeu Etnografik i Gjakovës është një shtëpi e cila funksionon si Muze duke prezentuar jetesën dhe elemente tradicionale shqiptare; Shtëpia e Familjes Qerkezi është një tjetër shtëpi e shndërruar në muze historik që dëshmon pasojat e luftës; Muzeu i Muzikës dhe Kulla e

Abdullah Pashë Drenit janë muze historik të Gjakovës.

Sipas hulumtimit fillestar të inicuar në kuadër të kësaj analize, është vërtetuar se Muzeu Etnografik dhe Shtëpia e Familjes Qerkezi operojnë në baza të rregullta ditore, çdo ditë pune dhe meraste të veçanta të festave apo organizimeve të tjera hapen edhe gjatë ditëve të pushimit.

Ndërsa Muzeu i Muzikës dhe Muzeu Historik – Kulla Abdullah Pashë Drenit në kohën e realizimit të këtij hulumtimi kanë qenë të mbyllur për shkak të renovimeve.



4.1. Gjendja ekzistuese e strukturave fizike

Muzetë e qytetit të Gjakovës operojnë në ndërtesa arkitektonike në gjendje relativisht të mirë fizike. Muzeu Etnografik operon në një shtëpi tradicionale të ruajtur dhe restauruar; Muzeu i Familjes Qerkezi operon në shtëpinë individuale të familjes Qerkezi. Në anën tjetër qasja në dy muzetë e tjerë nuk ka qenë e mundur për shkak të gjendjes së tyre në renovim. Muzeu i Muzikës nuk ka gjendje të mirë fizike për shkak të djegijes.

Fig. 3 Hartëzim i institucioneve muzeale të përfshira në hulumtim. (Burimi; Punuar nga autoret)



1. MUZEU ETNOGRAFIK I GJAKOVËS

Muzeu Etnografik i Gjakovës ndodhet në zemër të qytetit, përballë ndërtesës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës. Ndërtesa u ndërtua në vitin 1810 nga familja Sina dhe përfaqëson një shembull të shkëlqyer të arkitekturës tradicionale të asaj kohe. Shtëpia është ndërtuar në dy kate. Përdhësa është shfrytëzuar si depo për ruajtjen e materialeve dhe ushqimeve, ndërsa kati i sipërm ka shërbyer si hapësirë banimi. Kati i sipërm përmban katër dhoma dhe dy çardak (ballkone), të ndërtuara me mjeshtëri nga ndërtuesit nga Dibra. Për ndërtimin e shtëpisë janë përdorur materiale të qëndrueshme si tulla, guri dhe druri.




Fig. 4 Situacioni; Muzeu Etnografik i Gjakovës.
(Burimi: Punuar nga autoret)

Një nga tiparet më të spikatura të ndërtesës është dhoma e madhe, që ndodhet në anën e majtë të saj. Kjo dhomë dallohet për dekorimet e saj të larta artistike. Qymlekët me furrat e tyre janë vendosur në të katër dhomat, duke krijuar një harmoni funksionale dhe estetike. Koridori, i cili ndan dhomat nga njëra-tjetra, ka një planimetri në formë kryqi, një veçori karakteristike e arkitekturës tradicionale. Me kalimin e kohës, ndërtesa ka pësuar disa ndryshime. Pjesa e përparme fillimisht përmbante dy dhoma për miqtë dhe një shtallë me plemë, ku ruhej ushqimi i kafshëve. Në përdhese ndodhej shtëpia e zjarrit, ndërsa mbi të ndodheshin dy aznaoda (kthina ndihmëse), të vendosura pas ndërtesës, të cilat tani nuk ekzistojnë më.

Në vitin 1918, kjo shtëpi u shit nga pronarët e saj dhe kaloi në pronësi të Haxhi Osman Boshnjakut. Më vonë, Komuna e Gjakovës, përmes një kontrate me pronarët, e shndërroi ndërtesën në Muze Etnografik, duke u bazuar në vlerat e saj të jashtëzakonshme arkitekturore dhe artistike popullore. Sot, Muzeu Etnografik i Gjakovës shërben si një thesar kulturor që ruan dhe prezanton historinë, traditat dhe stilin e jetesës të Gjakovës dhe Kosovës së shekullit XIX.

2. SHTËPIA E FAMILJES QERKEZI

Muzeu i Familjes Qerkezi në Gjakovë është një nga vendet më të rëndësishme që dokumenton vuajtjet dhe krimet që janë kryer nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë. I hapur në 14 qershor 2016, për nder të Ditës së Çlirimit të Kosovës, ky muze ka një rëndësi të veçantë si një vend kujtimi për ata që humbën jetën dhe për ata që ende kërkojnë të vërtetën për krimet dhe vrasjet makabre të kryera gjatë periudhës së luftës. I ndodhur në qytetin e Gjakovës, muzeu është vendosur për të nderuar dhe ruajtur kujtimin e familjes Qerkezi, veçanërisht të nënës Ferdonije Qerkezi, e cila ka humbur katër djemtë dhe bashkëshortin gjatë luftës. Pavarësisht humbjes së madhe, ajo vendosi të krijonte një hapësirë për të mbajtur të gjallë kujtimin e familjes dhe për të treguar botërisht dhimbjen dhe vuajtjet që ajo ka përjetuar.



*Fig. 5 Situacioni; Shtëpia e Familjes Qerkezi.
(Burimi: Punuar nga autoret)*

Vendosmëria e Ferdonije Qerkezit për të ruajtur kujtimin e familjes përmes këtij muzeu është një dëshmi e fuqishme për të treguar të vërtetën mbi ngjarjet e vitit 1999 dhe pasojat e luftës. Vizita në muze është një mundësi për të mësuar mbi historinë e familjes Qerkezi dhe për të reflektuar mbi të kaluarën e Kosovës. Ky muze është një nga vendet e pakta që dokumenton në mënyrë të dukshme krimet që janë kryer gjatë periudhës së luftës, duke ofruar një pasqyrë të hidhur të ngjarjeve që kanë ndodhur.

Nëpërmjet eksponatëve të ndryshëm, si fotografi, objekte personale dhe dëshmi të tjera, muzeu jep një pamje të qartë të jetës para dhe pas luftës për familjen Qerkezi. Disa nga eksponatet përfshijnë edhe sende personale të familjarëve të humbur, që kanë një vlerë të jashtëzakonshme për vizitorët. Këto eksponate janë të mbushura me një ngarkesë emocionale, duke treguar tragjedinë që ka përjetuar kjo familje, dhe janë një mënyrë e fuqishme për të mbajtur gjallë kujtimin e tyre.

3. MUZEU I MUZIKËS

Muzeu i Muzikës në Gjakovë, i vendosur në qendër të qytetit, ka kaluar një sërë vështirësish që kanë ndikuar në funksionimin dhe zhvillimin e tij. Muzeu, që u hap në vitin 2016 dhe ndodhet në një ndërtesë historike të njohur si "Tabhane", është krijuar me synimin për të ruajtur dhe promovuar trashëgiminë muzikore të Gjakovës dhe Kosovës. Megjithatë, ky muze ka hasur shumë pengesa gjatë funksionimit të tij, të cilat kanë ndikur në zhvillimin e tij si një institucion kulturor aktiv dhe të qëndrueshëm.

Muzeu ka për qëllim të përfaqësoj traditat muzikore unike të popullit shqiptar,




Fig. 6 Situacioni; Muzeu i Muzikës. (Burimi: Punuar nga autoret)

me fokus në ruajtjen e instrumenteve historike, regjistrimeve dhe dorëshkrimeve muzikore. Kur muzeu të jetë plotësisht funksional, pritet të shërbejë si një institucion kulturor i rëndësishëm për Gjakovën dhe më gjerë, duke kontribuar në ruajtjen e historisë muzikore të rajonit.

Megjithë përpjekjet për restaurim, muzeu u shkatërrua përsëri nga një zjarr në vitin 2023 dhe, në kohën e realizimit të këtij projekti, është ende në proces restaurimi.

3. MUZEU HISTORIK - KULLA ABDULLAH PASHË DRENIT – MUZEU REGJIONAL

Muzeu Historik i Gjakovës ndodhet në Kullën e Abdullah Pashë Drenit, një ndërtesë trekatëshe, e ndërtuar në vitin 1790. Kulla ka shërbyer si shtëpi banimi dhe fortifikatë, e dëshmuar nga numri i madh i frenxhive që gjenden në të tre katet e saj. E ndërtuar me gurë natyralë dhe tulla të pjekura, kjo kullë ka vlera të mëdha arkitektonike dhe historike, duke përfshirë dritare të vogla dhe strukturë të fortifikuar.



Fig. 7 Situacioni; Kulla e Abdullah Pashë Drenit.
(Burimi: Punuar nga autoret)

Kulla ka luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e re shqiptare, pasi ka qenë pjesë e ngjarjeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ku figura të njohura si Abdullah Pashë Dreni dhe Maxharr Pasha kanë luajtur një rol të shquar. Gjatë periudhës së RSFJ-së, kjo kullë ka shërbyer si muze regjional. Këtu, pas bisedimeve të pasuksesshme më 1-3 shtator 1878, ka shpërthyer një luftë e përgjakshme, ku u vranë figura të rëndësishme si Mehmet Ali Pasha dhe Abdullah Pashë Dreni.

Sot, Kulla e Abdullah Pashë Drenit është shtëpia e Muzeut të Degës së Lidhjes Shqiptare në Gjakovë, që ruan dhe ekspozon artefakte dhe dokumente historike që lidhen me ngjarjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe luftën për liri. Ky muze është një nga objektet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të qytetit dhe përfaqëson një lidhje të rëndësishme mes historisë dhe arkitekturës së Gjakovës

4.1. Operimi i muzeve, kapacitetet njerëzore dhe shërbimet e ofruara


Menaxhimi dhe operimi i katër muzeve në Gjakovë i përket institucioneve të ndryshme:

Muzeu Etnografik i Gjakovës: Ky muze menaxhohet nga Komuna e Gjakovës. Ai u themelua për të ruajtur trashëgiminë e pasur kulturore dhe arkitekturore të rajonit, duke prezantuar traditat dhe historinë lokale.

Shtëpia e Familjes Qerkezi: Ky muze funksionon si një iniciativë private, e përkushtuar për të përkujtuar familjen Qerkezi dhe viktimat e luftës në Kosovë. Ai mbështetet dhe njihet publikisht, përfshirë vizitat nga zyrtarë që theksojnë rëndësinë e tij historike.

Muzeu i Muzikës: Ky muze është gjithashtu nën menaxhimin e institucioneve kulturore lokale. Ai përballet me sfida si restaurimi dhe financimi operativ, duke u mbështetur kryesisht te komuniteti dhe mbështetja komunale.

Kulla e Abdullah Pashë Drenit: Ky monument historik funksionon si pjesë e kornizës kombëtare të trashëgimisë, nën Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës. Ai është një monument i rëndësishëm që lidhet me ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit dhe historinë më të gjerë shqiptare.





4.2. Analiza e hapësirave dhe sekuencat e lëvizjeve

Për të dy muzetë e hapur është bërë analiza e tipologjive të hapësirave ekspozuese në relacion me sekuencat e lëvizjes së vizitorëve. Kjo me synimin e të kuptuarit të veçorive hapësinore që ato bartin dhe identifikimit të mangësive potenciale në kuadër të organizimit funksional si dhe kushteve tjera të cilatsi muze ato duhet t'i përmbushin (të specifikuar në kapitullin 3).

Muzetë aktuale të Gjakovës paraqesin tipologji të ndryshme të hapësirave ekspozuese, dhe është e vështirë të pozicionohen në njërin ndër tipologjitë e përcaktuara në kuadër të normativave të projektimit të ndërtesave muzeale. Kjo derivon edhe nga fakti se këta muze janë adaptuar nga ndërtesat me funksione të tjera dhe nuk janë projektuar fillimisht si muze.





Megjithëkëtë, sekuencat e lëvizjes janë lehtë të identifikueshme nga vizitorët, për shkak të organizimit funksional të qartë të kthinave dhe lehtë të lexueshëm, siç shihet në shtojcën grafike në vazhdim.

Përpos analizave në tipologjitë e hapësirave, thellësinë e tyre dhe shtrirjen funksionale të ndërtesave muzeale të bëra në gjendjen ekzistuese, në kuadër të këtij hulumtimi është bërë edhe analiza e lëvizshmërisë së vizitorëve për dy nga muzetë e hulumtuara; Muzeun Etnografik dhe Shtëpinë e Familjes Qerkezi. Lëvizshmëria e vizitorëve nuk është analizuar në rastin e Muzeut të Muzikës dhe Muzeut Historik - Kulla e Abdullah Pashë Drenit, duke qenë se ata kanë rezultuar në renovim në periudhën e realizimit të këtij hulumtimi.

Numërimet dhe përcjellja e vizitorëve në muzetë e analizuara është bërë në intervale kohore një orëshe, në tri periudha të ndryshme të ditës. Analiza e lëvizshmërisë është bërë në bazë të vrojtimit në periudha të caktuarakohore, rastisjes së vizitorëve, si dhe informatave të mbledhura nga ciceronët e muzeve.

Sipas të dhënave të mbledhura; trajektoren e lëvizshmërisë së vizitorëve dhe identifikimin e hapësirave me më së shumti interes për tu vizituar nga ana e vizitorëve janë prezentuar në ilustrimet e mëposhtme dhe poashtu, në mënyrë të detajuar, në shtojcën grafike.

Fig. 8 Tipologjitë e hapësirave të ekspozimit në objektet muzeale të Gjakovës në relacion me lëvizjen e publikut. (Burimi: Punuar nga autoret)

<p>MUZEU ETNOGRAFIK</p>		<p>Hapur, Qendror</p>
<p>SHTËPIA E FAMILJES QERKEZI</p>		<p>Linear</p>
<p>MUZEU I MUZIKËS</p>		<p>Linear</p>
<p>MUZEU HISTORIK- KULLA E ABDULLAH PASHË DRENIT</p>		<p>Linear</p>

4.3. Qasshmëria e personave me aftësi të kufizuara

Në aspektin e qasjes fizike, analiza e realizuar evidenton se muzetë e qytetit të Gjakovës përballen me nivele të ndryshme të qasshmërisë për personat me aftësi të kufizuara:

Muzeu Etnografik: Ndërtesa, e vendosur në një zonë qendrore dhe me vlera të jashtëzakonshme arkitekturore, është e zhvilluar në dy nivele. Megjithatë, mungesa e rampave dhe ashensorëve e bën të vështirë qasjen për personat me aftësi të kufizuara. Shkallët dhe disa nga hapësirat e ngushta kufizojnë lëvizjen e mjeteve ndihmëse. Njëkohësisht, tabelat shpjeguese dhe informacionet në formate të tjera, si alfabeti Braille, mungojnë.

Shtëpia e Familjes Qerkezi: E vendosur në një lokacion të përshtatshëm, ky muze ofron akses të kufizuar fizik për shkak të konfigurimit të ndërtesës dhe mungesës së rampave. Organizimi i hapësirave si shtëpi individuale përfshin disa dhoma të ndërlidhura përmes shkallëve, duke e bërë sfiduese qasjen për PAK.

Muzeu i Muzikës: Pas dëmtimeve nga zjarri, muzeu aktualisht është në proces restaurimi, çka kufizon plotësisht qasjen për vizitorët. Në të ardhmen, restaurimi duhet të përfshijë instalimin e rampave, ashensorëve dhe aksesin në format dixhital për vizitorët me aftësi të kufizuara.

Kulla e Abdullah Pashë Drenit: Si një strukturë historike dhe muze me tre kate, kjo kullë përballlet me sfida të mëdha në qasjen fizike. Shkallët e pjerrëta dhe mungesa e rampave apo ashensorëve bëjnë të pamundur lëvizjen vertikale për PAK.

Bazuar në këto gjetje, nevojitet ndërhyrje emergjente për të rritur qasjen fizike në të gjitha muzetë e Gjakovës. Këto masa duhet të përfshijnë instalimin e rampave, ashensorëve dhe përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese, si dhe pasurimin e tabelave shpjeguese dhe materialeve dixhitale për të siguruar një përvojë gjithëpërfshirëse për të gjithë vizitorët.

Përfundime dhe rekomandime

Muzetë janë institucione me rol kyç për shoqërinë, duke mbajtur epitetin e ruajtësve të trashëgimisë kulturore dhe historike. Ato nxisin edukimin, diskutimin dhe reflektimin për të kaluarën, duke shërbyer si platforma që mbështesin dialogun dhe zhvillimin intelektual. Muzeumet e qytetit të Gjakovës – Muzeu Etnografik, Shtëpia e Familjes Qerkezi, Muzeu i Muzikës dhe Kulla e Abdullah Pashë Drenit – luajnë një rol thelbësor në pasurimin e identitetit kulturor dhe historik të qytetit.

Nga analiza dhe dokumentimi i realizuar, janë evidentuar disa sfida dhe potenciale për zhvillimin e këtyre institucioneve, si dhe disa aspekte unike që ata ofrojnë:

1. **Vlerat historike dhe artistike:** Secili nga muzeumet paraqet aspekte unike të trashëgimisë së Gjakovës. Muzeu Etnografik ruan arkitekturën tradicionale dhe mbi 1,700 eksponate që pasqyrojnë jetën e përditshme.

Shtëpia e Familjes Qerkezi është një hapësirë e fuqishme për reflektimin mbi tragjedinë e luftës. Muzeu i Muzikës promovon trashëgiminë muzikore të rajonit, ndërsa Kulla e Abdullah Pashë Drenit është një simbol i historisë kombëtare shqiptare.

2. **Qasja dhe aksesibiliteti:** Të gjitha muzeumet janë lehtë të arritshme në kontekstin urban, por disa prej tyre nuk ofrojnë qasje për personat me aftësi të kufizuara. Për shembull, mungesa e rampave dhe materialeve shpjeguese ndikon në vizitën e plotë të disa grupeve të vizitorëve. Gjithashtu, për disa muzeume, lëvizja lineare dhe ndërlihdhja e hapësirave mbetet një sfidë për optimizimin e qasjes.

3. **Përfshirja e teknologjisë:** Teknologjia moderne është pak e përdorur për ta bërë më atraktive dhe interaktive eksperiencën muzeale. Mungesa e pajisjeve multimediale dhe materialeve dixhitale kufizon mundësitë e interpretimit dhe përvojës së vizitorëve.
4. **Problemet menaxheriale dhe mbështetja financiare:** Shumë muzeume ndeshen me sfida financiare, restaurime të papërfunduara dhe mungesë burimesh të përditshme operacionale. Modeli aktual i menaxhimit shpesh është i fragmentuar, duke ndikuar në efektivitetin e funksionimit.
5. **Ndikimi i ngjarjeve historike:** Zjarri i vitit 2023 dëmtoi Muzeun e Muzikës, duke e kthyer restaurimin dhe funksionimin e tij në një sfidë të vazhdueshme. Ky rast thekson nevojën për masa emergjente mbrojtëse dhe riparime të shpejta.
6. **Ndërlidhja me qytetarët:** Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe edukative në disa muzeume, si Muzeu Etnografik dhe Kulla e Abdullah Pashë Drenit, është një shembull pozitiv i përkushtimit ndaj komunitetit. Megjithatë, ka potencial për një qasje më të gjerë dhe për të përthithur grupe të ndryshme vizitorësh.
7. **Shenjëzimi dhe informacioni:** Mungesa e shenjëzuesve urbanë dhe tabelave informuese e bën të vështirë për vizitorët orientimin dhe marrjen e informacionit të nevojshëm për eksponatet. Informacionet aktuale shpesh janë të pamjaftueshme ose nuk përkthehen në gjuhë të huaja.

Rekomandime

Bazuar në analizën e realizuar dhe potencialet e identifikuara, propozojmë këto masa për përmirësimin dhe zhvillimin e muzeve të Gjakovës:

1. Restaurim dhe mbështetje financiare:

- Përfundimi i restaurimit të Muzeut të Muzikës dhe ruajtja e ekspoziteve të tjera me vlera të larta historike.
- Investime për përmirësimin e hapësirave ekspozuese dhe krijimin e ambienteve më miqësore ndaj vizitorëve.
- Sigurimi i fondeve emergjente për mbrojtjen dhe restaurimin e koleksioneve të rrezikuara.

2. Përmirësimi i qasshmërisë:

- Ndërhyrje për të garantuar qasje për PAK, duke përfshirë rampe, ashensorë dhe materiale shpjeguese në gjuhët lokale, gjuhën angleze dhe alfabetin Braille.
- Përditësimi i infrastrukturës me pajisje ndihmuese, si guida audio dhe aplikacione mobile.

3. Teknologjia dhe dixhitalizimi:

- Zhvillimi i aplikacioneve dhe platformave dixhitale për informacion mbi muzetë dhe ekspozitat.
- Integrimi i teknologjive interaktive si realiteti virtual i augmentuar për të pasuruar përvojën muzeale.
- Krijimi i arkivave dixhitale për studim dhe qasje të lehtë nga studiuesit dhe publiku.

4. Aktivitete dhe programe edukative:

- Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike për të gjitha grupmoshat.
- Ofimi i programeve edukative për shkollat dhe institucionet arsimore lokale.
- Nxitja e bashkëpunimeve me artistë, historianë dhe akademikë për të krijuar evente të reja që frymëzojnë kreativitetin dhe diskutimin.

5. Shenjzimi dhe orientimi:

- Vendosja e shenjzuesve në hapësira publike që tregojnë vendndodhjen, orarin dhe detajet e muzeve.
- Pasurimi i tabelave informuese brenda muzeve me të dhëna të detajuara mbi eksponatet.
- Zhvillimi i guidave të printuara dhe dixhitale me informacione historike dhe turistike të detajuara.

6. Unifikimi i menaxhimit dhe strategjive:

- Hartimi i një modeli unik menaxhimi për të gjitha muzetë, duke unifikuar vizionin dhe objektivat.
- Ngritja e kapaciteteve profesionale për stafin e muzeve, duke organizuar trajnime në menaxhimin kulturor dhe shërbimin ndaj vizitorëve.

7. Marketing dhe promovim:

- Përforsimi i promovimit në rrjetet sociale dhe mediat lokale dhe nacionale.
- Krijimi i paketave turistike që integrojnë muzetë si pjesë kyçe të atraksioneve të qytetit.
- Përfshirja e muzeve në ngjarje dhe festivale kombëtare për të rritur shikueshmërinë.

8. Hapësira të reja dhe mjedise rekreative:

- Krijimi i hapësirave mbështetëse si kafenetë, dyqane suveniresh dhe biblioteka të vogla.
- Shndërrimi i muzeve në mjedise që promovojnë kreativitetin dhe diskutimin.
- Shtimi i hapësirave multifunktionale që mund të shfrytëzohen për ekspozita të përkohshme, konferenca dhe punëtori.

Zbatimi i këtyre masave do ta shndërronte Gjakovën në një shembull model të ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, duke e bërë qytetin një pikë atraktive për vizitorët vendas dhe të huaj.

Duke u bazuar në analizat dhe rekomandimet e mësipërme, është e qartë se muzetë e Gjakovës kanë një potencial të jashtëzakonshëm për të luajtur një rol më të madh në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Përmes investimeve strategjike, përmirësimeve infrastrukturore dhe përfshirjes së teknologjive moderne, këto institucione mund të bëhen shembull i zhvillimit të qëndrueshëm kulturor. Nxitja e hulumtimeve të reja që eksplorojnë historinë dhe trashëgiminë lokale është një hap i domosdoshëm për të mbajtur gjallë identitetin kulturor të rajonit. Duke u kthyer në platforma interaktive dhe gjithëpërfshirëse, muzetë mund të shërbejnë si ura lidhëse midis së kaluarës dhe së ardhmes, duke frymëzuar vizitorët vendorë dhe ndërkombëtarë për brezat që do të vijnë.

Bibliografia

Alexander, E.P., dhe Alexander, M. *Museums in Motion: An Introduction to the History and Functions of Museums*. Rowman & Littlefield, 2007.

Britannica. "Museums Structure and Operation." Qasur në nëntor 2022. <https://www.britannica.com/topic/museum-cultural-institution/Museum-structure-and-operations>.

Definicioni i ri i muzeve, propozuar nga Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve (ICOM – International Council of Museums). Aprovuar në Konferencën e 26-të Gjenerale në Pragë, më 24 gusht 2022. Qasur në nëntor 2022. <https://icom.museum/en/news/icom-approves-a-new-museum-definition/>.

EC Ma Ndryshe. "Prizreni 'Qytet Muze' pa Muze?" Maj 2008. Qasur në nëntor 2022. <https://www.ecmandryshe.org/?page=1,17,530>.

EC Ma Ndryshe. "Udhëzim Administrativ - Për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara." 2016. Qasur në nëntor 2022. [161021105153 udhezimi administrativ.pdf](https://www.ecmandryshe.org/161021105153_udhezimi_administrativ.pdf)

Front Online. "Zbulohet pllaka 'Shtëpia e Durimit' në Shtëpinë Tradicionale të Familjes Qerkezi." 12 tetor 2023. Qasur më 12 dhjetor 2024. <https://frontonline.net>.

Gazeta Express. "Kulla e Abdullah Pashë Drenit si Monument Historik Kombëtar." Publikuar më 20 tetor 2023. Qasur më 12 dhjetor 2024. <https://gazetaexpress.com>.

Goode, G.B. "On the Classification of Museums." *Vol. 3, No. 57* (Janar 31, 1896), fq. 154-161.

Günay, B. "Museum Concept from Past to Present and Importance of Museums as Centers of Art Education." *International Conference on New Horizons in Education INTE2012*, 2012.

Jerliu, F. "Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017–2027." Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, 2016.

Koha Ditore. "Restaurimi i Tabhanes dhe Roli i Muzeut të Muzikës." Publikuar më 19 janar 2024. Qasur më 12 dhjetor 2024. <https://koha.net>.

Lajmi.net. "Historiku dhe Rëndësia e Kullës së Abdullah Pashë Drenit." Publikuar më 15 nëntor 2024. Qasur më 12 dhjetor 2024. <https://lajmi.net>.

Manifesta14. "Muzeu i Kosovës." Qasur në nëntor 2022. <https://manifesta14.org/sq/venue/muzeu-i-kosoves/>.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. "Miratohet Koncept-dokumenti për Art dhe Kulturë." Qasur në nëntor 2022. <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,3041>.

Montsho, G. "Making Museums Accessible to Those With Disabilities." *Museum Next*, 2022. Qasur në nëntor 2022. <https://www.museumnext.com/article/making-museums-accessible-to-those-with-disabilities/>.

RTK Story. "Kulla e Isa Boletinit." Publikuar më 10 maj 2021. Qasur më 10 janar 2024. https://www.youtube.com/watch?v=-IPJMV7_Es.

Telegrafi. "Muzeu i Muzikës në Gjakovë Ende në Proces Restaurimi Pas Zjarrit." Publikuar më 17 shkurt 2023. Qasur më 12 dhjetor 2024. <https://telegrafi.com>.

Tzortzi, K. *Museum Space – Where Architecture Meets Museology*. Routledge, 2016, fq. 11-43.

Lista e figurave

Fig. 1 Ilustrim i katër institucioneve muzeale të qytetit të Gjakovës të përshira në këtë hulumtim.

(Burimi: Punuar nga autoret)

Fig. 2 Muzeu Kombëtar i Kosovës, Prishtinë.

(Burimi: <https://manifesta14.org/sq/venue/muzeu-i-kosoves/>)

Fig. 3 Hartëzimi i institucioneve muzeale të përshira në hulumtim.

(Burimi: Punuar nga autoret)

Fig. 4 Situacioni; Muzeu Etnografik i Gjakovës.

(Burimi: Punuar nga autoret)

Fig. 5 Situacioni; Shtëpia e Familjes Qerkezi. *(Burimi: Punuar nga autoret)*

Fig. 6 Situacioni; Muzeu i Muzikës.

(Burimi: Punuar nga autoret)

Fig. 7 Situacioni; Kulla e Abdullah Pashë Drenit.

(Burimi: Punuar nga autoret)

Fig. 8 Tipologjitë e hapësirave të ekspozimit në objektet muzeale të Gjakovës në relacion me lëvizjen e publikut.

(Burimi: Punuar nga autoret)

PËR EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe

3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta. Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart.

Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;

2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;

3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;

4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.

Linku i uebfaqes së: [EC Ma Ndryshe](#)

SHTOJCA 1: DOKUMENTIMI DHE ANALIZA E INSTITUCIONEVE
MUZEALE TË QYTETIT TË GJAKOVËS

PJESA GRAFIKE


PËRMBAJTJA

MUZEU ETNOGRAFIK I GJAKOVËS **01**


SHTËPIA E FAMILJES QERKEZI **02**


MUZEU I MUZIKËS **03**

MUZEU HISTORIK - KULLA
ABDULLAH PASHË DRENT **04**

 SITUACIONI, VENDOSJA NË
KONTEKST URBAN

 PLANIMETRITË/ PRERJE / FASADA

 DOKUMENTIMI I GJENDJES
EKZISTUESE/ FOTOGRAFITË

 IDENTIFIKIMI I PENGESAVE NË
QASSHMËRI

 ZHVILLIMI I HAPËSIRAVE

 ANALIZA E LËVIZJES SË VIZITORËVE



LEGJENDA:

- 1 MUZEU ETNOGRAFIK I GJAKOVËS
- 2 SHTËPIJA E FAMILJES QERKEZI
- 3 MUZEU I MUZIKËS
- 4 MUZEU HISTORIK - KULLA E ABDULLAH PASHË DRENIT

GJAKOVA

1981

**MUZEU
ETNOGRAFIK I
GJAKOVËS**



2016

**SHTËPIJA E
FAMILJES
QERKEZI**



2016

**MUZEU I
MUZIKËS**




2010

**MUZEU HISTORIK -
KULLA E ABDULLAH
PASHË DRENT**



01



MUZEU ETNOGRAFIK I GJAKOVËS

MUZEU ETNOGRAFIK I GJAKOVËS





Muzeu Etnografik i Gjakovës ndodhet në zemër të qytetit, përballë ndërtesës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës. Ndërtesa u ndërtua në vitin 1810 nga familja Sina dhe përfaqëson një shembull të shkëlqyer të arkitekturës tradicionale të asaj kohe. Shtëpia është ndërtuar në dy kate. Përdhësa është shfrytëzuar si depo për ruajtjen e materialeve dhe ushqimeve, ndërsa kati i sipërm ka shërbyer si hapësirë banimi. Kati i sipërm përmban katër dhoma dhe dy çardak (ballkone), të ndërtuara me mjeshtëri nga ndërtuesit nga Dibra. Për ndërtimin e shtëpisë janë përdorur materiale të qëndrueshme si tulla, guri dhe druri.


Një nga tiparet më të spikatura të ndërtesës është dhoma e madhe, që ndodhet në anën e majtë të saj. Kjo dhomë dallohet për dekorimet e saj të larta artistike. Qymlekët me furrat e tyre janë vendosur në të katër dhomat, duke krijuar një harmoni funksionale dhe estetike. Koridori, i cili ndan dhomat nga njëra-tjetra, ka një planimetri në formë kryqi, një veçori karakteristike e arkitekturës tradicionale. Me kalimin e kohës, ndërtesa ka pësuar disa ndryshime. Pjesa e përparme fillimisht përmbante dy dhoma për miqtë dhe një shtallë me plemë, ku ruhej ushqimi i kafshëve. Në përdhese ndodhej shtëpia e zjarrit, ndërsa mbi të ndodheshin dy aznaoda (kthina ndihmëse), të vendosura pas ndërtesës, të cilat tani nuk ekzistojnë më.


Në vitin 1918, kjo shtëpi u shit nga pronarët e saj dhe kaloi në pronësi të Haxhi Osman Boshnjakut. Më vonë, Komuna e Gjakovës, përmes një kontrate me pronarët, e shndërroi ndërtesën në Muze Etnografik, duke u bazuar në vlerat e saj të jashtëzakonshme arkitekturore dhe artistike popullore. Sot, Muzeu Etnografik i Gjakovës shërben si një thesar kulturor që ruan dhe prezanton historinë, traditat dhe stilin e jetesës të Gjakovës dhe Kosovës së shekullit XIX.

SITUACIONI
P 1:200









Muzeu Etnografik i Gjakovës u shndërrua në muze në vitin 1981, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit. Ndërtesa, e ndërtuar fillimisht në vitin 1810 paraqet një shembull të shkëlqyer të arkitekturës tradicionale shqiptare. Kjo hapësirë unike, e restauruar me kujdes, sot mirëpret vizitorë vendas dhe ndërkombëtarë, duke mbajtur gjallë kulturën dhe historinë lokale.



FASADA KRYESORE

P 1:100



Muzeu Etnografik ka rol edukativ të rëndësishëm, duke tërhequr vizitorë vendas dhe të huaj, si dhe duke mirëpritur grupe nxënësish që mësojnë për traditat dhe historinë e vendit të tyre. Kjo ndërtesë, që fillimisht ka qenë pronë private, është transformuar në një ndërtesë publike të dedikuar për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, duke e bërë atë një nga destinacionet më të rëndësishme turistike dhe edukative të qytetit.






Muzeu Etnografik i Gjakovës paraqet një koleksion të pasur eksponatesh që pasqyrojnë jetën e përditshme dhe traditat e qytetit dhe rajonit përreth. Koleksioni përfshin mbi 1,700 artefakte, duke përfshirë vegla bujqësore, orendi tradicionale të amvisërisë dhe enë të punuara me mjeshtëri nga zejtarët e Gjakovës.

Hapësirat e muzeut janë organizuar në mënyrë që të shfaqin aspekte të ndryshme të trashëgimisë kulturore. Kati përdhes shërben për të prezentuar punimin e zejeve të ndryshme të aplikuar në Gjakovë dhe më tej, ndërsa kati i sipërm është i ndarë në dhoma tematikisht të organizuara.




PAMJE TË MUZEUT - SITUACIONI DHE PËRHHESA

PAMJE TË MUZEUT - KATI 1



Çdo dhomë në katin e këtij muzeu është e dedikuar për një aspekt të veçantë të jetës tradicionale, si për shembull dhomat e banimit me orëdi origjinale, që paraqesin skena nga jeta e përditshme. Në korridorin kryesor dhe dhomat e tjera ndodhen qymlekët me furra dhe enë bakri, të cilat janë të vendosura në mënyrë autentike për të ilustruar stilin e jetesës së shekullit XIX. Hapësirat e muzeut janë dizajnuar për të krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet vizitorëve dhe traditave kulturore të rajonit.






Muzeu Etnografik i Gjakovës ndodhet në qendër të qytetit, duke ofruar një qasje të lehtë për vizitorët që vijnë nga ky zonë dhe stacioni i autobusëve. Megjithatë, muzeu në hyrje ka disnivel mirëpo nuk ka një rampë për personat me aftësi të kufizuara, duke e kufizuar qasjen për këtë grup të vizitorëve.

Ndërtesa është e zhvilluar në dy nivele: përdhesë dhe katin e parë. Kati i muzeut është i qasshëm vetëm përmes shkallëve, të cilat kanë një pjerrtësi të madhe që e bën të pamundur ngjitjen me mjete ndihmëse. Po ashtu, muzeu ka një mungesë të materialeve shpjeguese dhe informacionit në audio për artefaktet e ekspozuara, duke e bërë kështu të vështirë për vizitorët me aftësi të kufizuara të kenë një kuptim të plotë të historisë dhe kulturës që paraqiten në ekspozita.

Ndërtesa ka shkallë të tipit kundërzjarri për t'u aksesuar, por kthina që çon tek këto shkallë është e mbyllur për vizitorët.



PËRDHESA

KATI 1

ANALIZA E QASSHMËRISË

Shkallët e pjerrta



Disnivelimet në situacion






Lartësi në hyrje të kthinave






Korridor i ngushtë



ANALIZAT NË PËRDHESË



ANALIZAT NË KATIN E PARË



ANALIZA E NDËRLIDHJES SË KTHINAVE TË MUZEUT

Vija që tregon ndërlidhjen e kthinave →
 Hapësirë e mbyllur për vizitorë ■

ANALIZA E THELLËSISË SË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE

Kthina e parë e muzeut 0
 Kthina direkte pas kthinë së parë 1
 Kthina direkte pas kthinë së dytë 2


ANALIZA E ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE

Hapësira që lidhet vetëm me 1 hapësirë tjetër ■
 Hapësira që lidhet me 2 hapësira të tjera ■
 Hapësira që lidhet me 7 hapësira të tjera ■

ANALIZA E LËVIZJES SË VIZITORËVE NË PËRHDESE TË MUZEUT ETNOGRAFIK

-NR. I VIZITORËVE 30 10 5 2 1 0



F M



ANALIZA E LËVIZJES SË VIZITORËVE NË KATIN 1 TË MUZEUT ETNOGRAFIK

-NR. I VIZITORËVE 78 20 5 2 1 0

F M




- Vija e lëvizjes së vizitorëve
- Drejtimi i lëvizjes
- Pikat ku vizitori ka qëndruar më gjatë
- Hapesire e mbyllur per vizitore

KARAKTERISTIKAT TE LËVIZJA E VIZITORËVE DHE MUZEU

Stafi i Muzeut Etnografik të Gjakovës ka investuar përpjekje të konsiderueshme për të mbledhur, ruajtur dhe restauruar eksponate të cilat përfaqësojnë trashëgiminë kulturore dhe historike të qytetit. Këto përfshijnë artefakte nga jeta e përditshme, kultura bujqësore dhe blegtorale, si dhe objekte të punuara nga zejtarët e njohur të Gjakovës. Muzeu është një hapësirë kyçe për studimin dhe interpretimin e trashëgimisë materiale, ku vizitorët mund të njohin më mirë aspekte të jetës tradicionale dhe zhvillimet e kulturës lokale.



Lëvizja e vizitorëve nëpër hapësirat e muzeut udhëhiqet nga ciceronë të cilët ofrojnë informacion për çdo dhomë dhe ekspozitë. Nga përdhesa, ku prezantohen zejjet tradicionale, deri tek kati me kthinat e tjera që ekspozojnë pjesë të jetës së përditshme dhe elemente të jetesës tradicionale, vizitorët mund të thellohen në çdo detaj. Disa nga elementet më tërheqëse të ekspozitave përfshijnë kutinë e pajës për nuset, enët e bakrit, tirqet për fëmijë, veshjet tradicionale, veglat dhe mjetet e punës, si dhe lodrat dhe punimet e dorës. Një veçori interesante është prezantimi i këtyre objekteve edhe përmes fotografive të shoqëruara me planimetria që ilustrojnë përdorimin e tyre në jetën e përditshme.

Një nga pjesët më tërheqëse të muzeut janë veshjet tradicionale, sidomos ato solemne të qëndisura me fije ari, të cilat dëshmojnë për mjeshtërinë dhe estetikën e lartë të artizanëve të së kaluarës. Veshjet, të cilat përfaqësojnë krenarinë dhe historinë e Gjakovës, janë një nga pasuritë më të rëndësishme të këtij muzeu dhe ofrojnë një shikim të thellë në traditat dhe kulturën e rajonit.



Muzeu Etnografik i Gjakovës ka një strukturë qendrore që shtrihet në dy nivele, me përdhesën dhe katin e sipërm. Përdhesa është hapësira që përmban ekspozitat më të hershme dhe ato që lidhen me zejët tradicionale të qytetit, si vegla pune, elemente të përditshmërisë, dhe produkte artizanale.



Në katin e sipërm, muzeu ofron një ekspozitë që ilustron aspekte të tjera të jetës tradicionale, përfshirë veshje, mobilie, dhe artefakte. Hapësirat janë të ndara në disa kthina, dhe çdo njëra prej tyre tregon një aspekt të jetës sociale, familjare dhe profesionale të Gjakovës në periudha të ndryshme. Pas përfundimit të vizitës, vizitorët kthehen përmes të njëjtës rrugë dhe dalin nga muzeu. Kjo shtrirje e hapësirave është e dizajnuar për të ofruar një përvojë të rregullt dhe të organizuar për vizitorët, duke siguruar që ata të mund të eksplorojnë të gjitha ekspozitat pa ndonjë pengesë.



ZHVILLIMI I HAPËSIRAVE

ANALIZAT NË PËRDHESË

ANALIZAT NË KATIN 1



- Kthina e parë e muzeut - 0
- Kthina e dytë e muzeut - 1
- Kthina e tretë e muzeut - 2
- Kthina e katërt e muzeut - 3

- Hapësira që lidhet vetëm me 1 hapësirë tjetër ●
- Hapësira që lidhet me 2 hapësira të tjera ●
- Hapësira që lidhet me 7 hapësira të tjera ●



02



SHTËPIA E FAMILJES QERKEZI

SHTËPIA E FAMILJES QERKEZI



Muzeu i Familjes Qerkezi në Gjakovë është një nga vendet më të rëndësishme që dokumenton vuajtjet dhe krimet që janë kryer nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë. I hapur në 14 qershor 2016, për nder të Ditës së Çlirimit të Kosovës, ky muze ka një rëndësi të veçantë si një vend kujtimi për ata që humbën jetën dhe për ata që ende kërkojnë të vërtetën për krimet dhe vrasjet makabre të kryera gjatë periudhës së luftës. I ndodhur në qytetin e Gjakovës, muzeu është vendosur për të nderuar dhe ruajtur kujtimin e familjes Qerkezi, veçanërisht të nënës Ferdonije Qerkezi, e cila ka humbur katër djemtë dhe bashkëshortin gjatë luftës. Pavarësisht humbjes së madhe, ajo vendosi të krijonte një hapësirë për të mbajtur të gjallë kujtimin e familjes dhe për të treguar botërisht dhimbjen dhe vuajtjet që ajo ka përjetuar.


Vendosmëria e Ferdonije Qerkezit për të ruajtur kujtimin e familjes përmes këtij muzeu është një dëshmi e fuqishme për të treguar të vërtetën mbi ngjarjet e vitit 1999 dhe pasojat e luftës. Vizita në muze është një mundësi për të mësuar mbi historinë e familjes Qerkezi dhe për të reflektuar mbi të kaluarën e Kosovës. Ky muze është një nga vendet e pakta që dokumenton në mënyrë të dukshme krimet që janë kryer gjatë periudhës së luftës, duke ofruar një pasqyrë të hidhur të ngjarjeve që kanë ndodhur.

Nëpërmjet eksponatëve të ndryshëm, si fotografi, objekte personale dhe dëshmi të tjera, muzeu jep një pamje të qartë të jetës para dhe pas luftës për familjen Qerkezi. Disa nga eksponatet përfshijnë edhe sende personale të familjarëve të humbur, që kanë një vlerë të jashtëzakonshme për vizitorët. Këto eksponate janë të mbushura me një ngarkesë emocionale, duke treguar tragjedinë që ka përjetuar kjo familje, dhe janë një mënyrë e fuqishme për të mbajtur gjallë kujtimin e tyre.


SITUACIONI
P 1:200





PËRDHESA
P 1:100



KATI 1
P 1:100







SHPJEGIM I KTHINAVE TË MUZEUT

Qëndrimi ditor - Dhoma e Zonjës Ferdonije

Tualet i shfrytëzueshëm nga vizitorët


Shkallët të cilat dërgojnë në bodrum

Shkallët të cilat dërgojnë në Katin 1

Zyre/ Hapësirë e ekspozimit të fotografive dhe veshmbathjeve

Parahyrja/Korridor

Rampa që dërgon në bodrum/
vendin ku është zhvilluar ngjarja




Dhoma e ditës




Tualet i pashfrytëzueshëm nga vizitorët

Shkallët të cilat lidhen me përdheshën dhe me nënkuilmin (jo i hapur për vizitorët)




Dhomat e dy djemve të martuar 3 muaj para ngjarjes. Dhomat kanë gjësendet personale të ruajtura plotësisht.



ANALIZAT NË PËRDHESË



ANALIZAT NË KATIN E PARË



ANALIZA E NDËRLIDHJES SË
KTHINAVE TË MUZEUT


Vija që tregon ndërlidhjen e kthinave →
Hapësirë e mbyllur për vizitorë

ANALIZA E THELLËSISË SË
ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE

Kthina e parë e muzeut 0
Kthina direkte pas kthinë së parë 1
Kthina direkte pas kthinë së dytë 2

ANALIZA E ZHVILLIMIT TË
HAPËSIRAVE

Hapësira që lidhet vetëm me 1 hapësirë tjetër
Hapësira që lidhet me 2 hapësira të tjera
Hapësira që lidhet me 5 hapësira të tjera




PAMJE TË MUZEUT - KATI 1

ANALIZA E LËVIZJES SË VIZITORËVE NË PËRHHDESË TË MUZEUT ETNOGRAFIK

Shtëpia Tradicionale e Familjes Qerkezi-Muzeu Historik, hap dyert për vizitorët në varësi të kërkesave të tyre. Kjo është ende një shtëpi banimi, ku nënë Ferdonije Qerkezi vazhdon të jetojë. Kthina e parë që ndodhet pas hyrjes është dhoma ku ajo qëndron, dhe përveç rasteve kur vizitorët dëshirojnë ta takojnë personalisht, kjo dhomë mbetet e mbyllur dhe nuk është pjesë e ekspozitës.


Lëvizja e vizitorëve nëpër muze realizohet nën udhëheqjen e ciceronit, zakonisht duke ndjekur një itinerar të caktuar. Vizitorët kalojnë fillimisht përmes parahyrjes dhe shkojnë në katin e sipërm, ku vizitojnë dhomën ditore, e cila pasqyron jetën e përditshme të familjes. Pas kësaj, ata kalojnë në dy dhomat e djemve, të cilat janë ekspozuar për të treguar më shumë rreth jetës së kësaj familjeje gjatë periudhës para luftës. Këto dhoma janë të mbushura me objekte që pasqyrojnë traditat dhe historinë e familjes Qerkezi. Në rast të fluksit të madh të vizitorëve, ky itinerar lejon një rrjedhë të organizuar të lëvizjes, që garanton se çdo vizitor do të ketë mundësinë të shijojë eksperiencën e vizitës në muze.

Përveç këtyre, hapësira e ciceronit gjithashtu ka elemente të ekspozuara që mund të vizitohen nga vizitorët. Kjo ndihmon për të pasuruar përvojën e vizitës dhe ofron një pamje më të thelluar të jetës në këtë shtëpi para dhe pas luftës. Poashtu, nëna Ferdonije i mirëpret ata që kërkojnë të vizitojnë bodrumin, dhomën e saj të ditës dhe oborrin e brendshëm, megjithëse ato hapësira nuk i takojnë ekspozitës së përhershme.



-NR. I VIZITORËVE 30 10 5 2 1 0



F M





ORA 15-16 13-14 11-12

- Vija që vizitorët përshkojnë zakonisht
- Vija e vizitorëve që shprehin interesim për vizitë në kthina tjera
- Drejtimi i lëvizjes
- Pikat ku vizitori ka qëndruar më gjatë



Muzeu i Familjes Qerkezi ka një organizim të thjeshtë dhe funksional të hapësirave ekspozuese, të cilat janë adaptuar nga vet funksioni i shtëpisë për të siguruar një kalim të natyrshëm dhe të kuptueshëm për vizitorët. Hapësirat janë të ndara në dhoma të caktuara që paraqesin pjesë të ndryshme të historisë familjare të Qerkezëve. Vizitorët mund të kalojnë nga një dhomë në tjetrën në mënyrë lineare, që nxit një lëvizje të organizuar përmes ekspozitave. Kjo qasje siguron që vizitorët të mund të shqyrtojnë secilin element të ekspozuar në detaje dhe të kuptojnë më mirë rëndësinë e çdo pjese të ekspozitës.



ANALIZAT NË PËRDHESË



ANALIZAT NË KATIN 1



- Kthina e parë e muzeut - 0
- Kthina e dytë e muzeut - 1
- Kthina e tretë e muzeut - 2
- Kthina e katërt e muzeut - 3

- Hapësira që lidhet vetëm me 1 hapësirë tjetër ●
- Hapësira që lidhet me 2 hapësira të tjera ●
- Hapësira që lidhet me 5 hapësira të tjera ●



Dollapi i këpucëve të familjes Qerkezi/
një dëshmi e ngrirë në kohë



03



MUZEU I MUZIKËS


MUZEU I MUZIKËS




Muzeu i Muzikës në Gjakovë, i vendosur në qendër të qytetit, ka kaluar një sërë vështirësish që kanë ndikuar në funksionimin dhe zhvillimin e tij. Muzeu, që u hap në vitin 2016 dhe ndodhet në një ndërtesë historike të njohur si "Tabhane", është krijuar me synimin për të ruajtur dhe promovuar trashëgiminë muzikore të Gjakovës dhe Kosovës. Megjithatë, ky muze ka hasur shumë pengesa gjatë funksionimit të tij, të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e tij si një institucion kulturor aktiv dhe të qëndrueshëm.

Muzeu ka për qëllim të përfaqësoj traditat muzikore unike të popullit shqiptar, me fokus në ruajtjen e instrumenteve historike, regjistrimeve dhe dorëshkrimeve muzikore. Kur muzeu të jetë plotësisht funksional, pritet të shërbejë si një institucion kulturor i rëndësishëm për Gjakovën dhe më gjerë, duke kontribuar në ruajtjen e historisë muzikore të rajonit.


Megjithë përpjekjet për restaurim, muzeu u shkatërroi përsëri nga një zjarr në vitin 2023 dhe, në kohën e realizimit të këtij projekti, është ende në proces restaurimi.



**PËRDHESA
P 1:100**




**KATI 1
P 1:100**








PRERJA A-A
P 1:100






FASADA KRYESORE
P 1:100



ANALIZAT NË PËRDHESË



ANALIZAT NË KATIN E PARË



ANALIZA E NDËRLIDHJES SË KTHINAVE TË MUZEUT

Vija që tregon ndërlidhjen e kthinave →
 Hapësirë e mbyllur për vizitorë ■



ANALIZA E THELLËSISË SË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE

Kthina e parë e muzeut ○
 Kthina direkte pas kthinë së parë ○
 Kthina direkte pas kthinë së dytë ○

ANALIZA E ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE


Hapësira që lidhet vetëm me 1 hapësirë tjetër ■
 Hapësira që lidhet me 2 hapësira të tjera ■
 Hapësira që lidhet me 4 hapësira të tjera ■

Muzeu i Muzikës në Gjakovë ka një organizim të thjeshtë dhe funksional të hapësirave ekspozuese, që është ndarë në dy nivele: përdhese dhe katin e parë. Lëvizja e vizitorëve brenda muzeut është lineare, duke udhëhequr vizitorët nga një hapësirë në tjetrën.. Lëvizja fillon nga hyrja kryesore dhe vazhdon nëpër vitrina ekspozuese në përdhese, duke kaluar nëpër dhomat ekspozuese. Më pas, vizitorët mund të ngjiten në katin e sipërm, ku ekspozita vazhdon në hapësirat e tjera.




ZHVILLIMI I HAPËSIRAVE



ANALIZAT NË PËRDHESË



ANALIZAT NË KATIN E PARË



Kthina e parë e muzeut - 0
 Kthina e dytë e muzeut - 1
 Kthina e tretë e muzeut - 2



Hapësira që lidhet vetëm me 1 hapësirë tjetër ●
 Hapësira që lidhet me 2 hapësira të tjera ●
 Hapësira që lidhet me 4 hapësira të tjera ●



MUZEU I MUZIKËS PARA DHE PAS DJEGJES NGA ZJARRI





MUZEU I MUZIKËS GJATË PERIUDHËS SË REALIZIMIT TË KËTUJ HULUMTIMI:

04



**MUZEU HISTORIK - KULLA E
ABDULLAH PASHË DRENIT**

MUZEU HISTORIK - KULLA E ABDULLAH PASHË DRENIT- MUZEU REGJIONAL




Muzeu Historik i Gjakovës ndodhet në Kullën e Abdullah Pashë Drenit, një ndërtesë trekatëshe, e ndërtuar në vitin 1790. Kulla ka shërbyer si shtëpi banimi dhe fortifikatë, e dëshmuar nga numri i madh i frenxhivë që gjenden në të tre katet e saj. E ndërtuar me gurë natyralë dhe tulla të pjekura, kjo kullë ka vlera të mëdha arkitektonike dhe historike, duke përfshirë dritare të vogla dhe strukturë të fortifikuar.

Kulla ka luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e re shqiptare, pasi ka qenë pjesë e ngjarjeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ku figura të njohura si Abdullah Pashë Dreni dhe Maxharr Pasha kanë luajtur një rol të shquar. Gjatë periudhës së RSFJ-së, kjo kullë ka shërbyer si muze regjional. Këtu, pas bisedimeve të pasuksesshme më 1-3 shtator 1878, ka shpërthyer një luftë e përgjakshme, ku u vranë figura të rëndësishme si Mehmet Ali Pasha dhe Abdullah Pashë Dreni.

Sot, Kulla e Abdullah Pashë Drenit është shtëpia e Muzeut të Degës së Lidhjes Shqiptare në Gjakovë, që ruan dhe ekspozon artefakte dhe dokumente historike që lidhen me ngjarjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe luftën për liri. Ky muze është një nga objektet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të qytetit dhe përfaqëson një lidhje të rëndësishme mes historisë dhe arkitekturës së Gjakovës


SITUACIONI

P 1:200




PËRDHESA


P 1:100



KATI 1


P 1:100






FASADA KRYESORE
P 1:200

ANALIZAT NË PËRDHESË



ANALIZAT NË KATIN E PARË



ANALIZA E NDËRLIDHJES SË KTHINAVE TË MUZEUT

Vija që tregon ndërlidhjen e kthinave →
 Hapësirë e qasshme - Asnjë



ANALIZA E THELLËSISË SË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE

Kthina e parë e muzeut 0
 Kthina direkte pas kthinë së parë 1
 Kthina direkte pas kthinë së dytë 2
 Kthina direkte pas kthinë së tretë 3

ANALIZA E ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE


Hapësira që lidhet vetëm me 1 hapësirë tjetër
 Hapësira që lidhet me 2 hapësira të tjera
 Hapësira që lidhet me 3 hapësira të tjera

Kulla e Abdullah Pashë Drenit- Muzeu Historik ka një organizim të thjeshtë dhe funksional të hapësirave ekspozuese, që është ndarë në tri nivele: përdhese, katin e parë dhe të dytë. Lëvizja e vizitorëve brenda muzeut është lineare, duke udhëhequr vizitorët nga një hapësirë në tjetrën.. Lëvizja fillon nga hyrja kryesore në përdhese, duke kaluar nëpër dhomat e tjera tutje nga përdhese në kate.



ZHVILLIMI I HAPËSIRAVE


ANALIZAT NË PËRDHESË



ANALIZAT NË KATIN E PARË



Kthina e parë e muzeut - 0
 Kthina e dytë e muzeut - 1
 Kthina e tretë e muzeut - 2



Hapësira që lidhet vetëm me 1 hapësirë tjetër ●
 Hapësira që lidhet me 2 hapësira të tjera ●
 Hapësira që lidhet me 3 hapësira të tjera ●

